



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “RRUGA E RE BILÇË - DROBONIK”, DHE MIRATIMIN  
NË PARIM TË PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT**

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, 2024, pasi u njoh me materialin “Mbi miratimin e Projektit ‘Ndërtim Rruga e Re Bilçë-Drobonik dhe miratimin në parim të procedurave të shpronësimit’, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 7 pika 2, neni 8,9 dhe 54, ligjit nr.107/2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e projektit ‘**Rruga e re Bilçë – Drobonik**
2. Miratimin në parim të procedurave të shpronësimit për projektin “**Rruga e re Bilçë - Drobonik**”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve dhe Komisioni i Shpronësimit pranë Bashkisë Berat.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin Ceca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT NË PËRDORIM TË ASETEVE NGA  
BASHKIA BERAT DHE AGJENSIA E SHËRBIMEVE TË BASHKISË BERAT,  
TEK SHA "BERAT CITY GREEN" SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË  
AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, pika c, neni 54, VKM nr.248, datë 27.03.2013 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Otlak të qarkut Berat, Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 " Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ", i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2014, datë 31.07.2014 " Për ndarjen administrative – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e transferimit në përdorim të aseteve nga Bashkia Berat dhe Agjencia e Shërbimeve Publike e Bashkisë Berat, tek SHA "BERAT CITY GREEN" SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT si vijon:

1.Shesh Depozitimi i mbetjeve urbane të Bashkisë Berat me numër pasurie 1406,1365/21,1365/23, 1365/22 Zona kadastrale 1587,Fshati Dushnik, Njësia Administrative "Otlak".

2.Tregu i Gjelbërt për tregëtimin e produkteve fruta perime të fermerëve, në Rajonin nr. 1.Zona kadastrale 8501 , nr pasurise 11/4 dhe 11/354.

3.Buldozer LR 634, viti i prodhimit 2005, model "Libeher LR 634", për mirëmbajtjen e sheshdepozimit të Bashkisë Berat transferohet nga Agjencia e Shërbimeve Publike tek SHA Berat City Green .

4.Kamion IVECO Daily, viti i prodhimit 2023, kapaciteti 2998 CCM, numri i shasisë ZCFCE 70BXCO5590, targa AB 301NL për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme transferohet tek SHA Berat City Green



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

- 5.Kontenierë për mbetjet e riciklueshme copë 1200, volumi 240 litra .
- 6.Kontenierë për mbetjet e riciklueshme, cope 120, volumi 1.1 m3.
2. Me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave, Drejtoria e Agjensisë së Shërbimeve Publike.

**KRYETAR**  
Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TE MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE TE NGURTA URBANE DHE TRANSFERIMIN E KËTIJ SHËRBIMI NË SH.A "BERAT CITY GREEN" SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 7 pika 2, neni 9 pika 1.1 germa b, neni 64 germa a, Ligjin nr.10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, " VKM nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve ", VKM nr.113, datë 1.3.2023 " Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ", i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Vendimin Nr . 60 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I :**

- 1.Miratimin e Studimit të Menaxhimit të integruar të Mbetjeve të ngurta Urbane të Bashkisë Berat.
2. Ofrimi i shërbimeve të parashikuara në studimi të kryhet nëpërmjet SH.A "Berat City Green" me aksione 100% të Bashkisë Berat.
- 3.Bashkia Berat ti kalojë SH.A "Berat City Green ", shumën prej 10,000,000 lekësh, fond i cili do të merret nga buxheti vjetor i programit të shërbimeve publike për shërbimin e pastrimit.
- 4.Me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave, Drejtoria e Agjensisë së Shërbimeve Publike.

**KRYETAR**  
Ervin Ceca